

SHKOLLA SHQIPTARE E ADMINISTRATËS PUBLIKE

RAPORT VJETOR

Viti 2022



Copyright © Shkolla Shqiptare e Administratës Publike 2023

Raport Vjetor 2022

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky publikim mund të sigurohet nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), adresa: Bulevardi “Zhan D’Ark, Nr.31” Tiranë, Shqipëri. Përdorimi i këtyre të dhënave nuk mund të bëhet pa miratimin e ASPA. Kërkesa për të fituar të drejtën e riprodhimit ose të përkthimit për qëllime fitimi ose jo, duhet t’i drejtohet Shkollës Shqiptare të Administratës Publike në adresën e mësipërme.

Email: aspa@aspa.gov.al

Adresa: BLV “Zhan D’Ark, Nr.31 Tiranë, Shqipëri

PASQYRA

Përmbledhja	4
1. Plotësimi i nevojave dhe kërkesave për trajnim, të dhëna të përgjithshme.....	6
2. Trajnim për Trajnerët (ToT).....	9
3. Trajnimi i detyrueshëm “Prezantimi me Administratën Publike”.....	9
4. Trajnimet në zbatim të proceseve të punës me afate ligjore.....	9
5. Trajnime sipas fushave.....	10
6. Trajnimet në fushën e Bashkimit Evropian.....	13
7. Vlerësimi i nevojave për trajnim.....	16
8. Hartimi i kurrikulave të reja.....	16
9. Bashkëpunimi me partnerët.....	19
10. Kontrolli i të dhënave.....	22
11. Vlerësimi i trajnimeve nga pjesëmarrësit.....	24
12. Numri i vlerësimeve të trajnerëve sipas llojit të trajnimit nga pjesëmarrësit.....	25
13. Vlerësimi i efektivitetit të trajnimit sipas llojit të trajnimit.....	26
14. Informimi për trajnimet/aktivitetet dhe rrjetet zyrtare të ASPA.....	35
15. Rekrutimi i trajnerëve.....	36
16. Vlerësimi i shkollës nga trajnerët.....	38
17. Analiza e veprimtarisë trajnuese ASPA.....	40

PËRMBLEDHJA



Shkolla Shqiptare e Administratës Publike është institucion publik qendror, me autonomi administrative dhe akademike, që ka për qëllim formimin e nëpunësve të institucioneve të administratës shtetërore, njësisve të vetëqeverisjes vendore, si dhe të institucioneve të pavaruara. ASPA ushtron veprimtarinë e saj prej vitit 2000, fillimisht e organizuar si Instituti i Trajnimit të Administratës Publike (ITAP) dhe prej vitit 2013, si Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. Organizimi dhe funksionimi i ASPA rregullohet me ligjin

nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe vendimin nr.138 datë 12/03/2014, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, trajnimin e nëpunësve civilë, si dhe të çdo individi tjetër jashtë shërbimit civil”, i ndryshuar. ASPA ofron shërbime të ndryshme në kuadër të programit të trajnimit në klasë, programit të trajnimit për trajnerë, programit të intershipit, programit e-learning, etj. ASPA bashkëpunon me trajnerë që vijnë nga bota akademike, administrata publike, si dhe ekspertiza lokale e fushave të ndryshme. Gjatë vitit 2022 ASPA ka zhvilluar trajnime në klasë, trajnime për trajnerë, trajnimin e detyrueshëm si dhe sesione informuese.

ASPA gjatë vitit 2022 ka trajnuar **5397** individë dhe ka patur një ndjekje prej **20780** pjesëmarrësish. Trajnimet në fushën e Integritimit Evropian janë ndjekur nga **3755** pjesëmarrës. Gjithashtu gjatë këtij viti ASPA ka trajnuar **1195** individë në trajnimin e detyrueshëm për nëpunësit në periudhë prove “Prezantimi me Administratën Publike”. Në total janë zhvilluar **665** ditë trajnimi nga të cilat **139** janë në bashkëpunim me projektet.

Gjatë kësaj periudhe ASPA, në përmbushje të nevojave për trajnim, ka vijuar punën për hartimin e kurrikulave të reja, i cili është bërë edhe me mbështetjen e programeve dhe donatorëve me të cilët ASPA bashkëpunon.

Në kuadër të vijimit të shërbimeve dhe cilësisë së tyre, ASPA gjatë vitit 2022 ka rekrutuar **60** trajnerë të rinj për t'u angazhuar në trajnimet për Kapitujt e Acquis së Bashkimit Evropian dhe **10** trajnerë për t'u angazhuar në trajnimet për Kodin e Procedurave Administrative, Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Organizimin dhe funksionimin e Administratës Publike, Sistemin e Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik dhe Sistemin e Menaxhimit të Aplikimeve (AMS). Rëndësi e veçantë i është dhënë edhe informimit të administratës publike dhe më gjërë mbi aktivitetet dhe zhvillimet më të fundit që shkolla ka zhvilluar.

Në fillim të muajit Tetor, ASPA filloi procesin e vlerësimit të nevojave për trajnim për vitin 2023, duke përfshirë të gjitha institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.



PLOTËSIMI I NEVOJAVE DHE KËRKESAVE PËR TRAJNIM

1. PLOTËSIMI I NEVOJAVE DHE KËRKESAVE PËR TRAJNIM

Bazuar në programin e trajnimit të miratuar nga Këshilli Drejtues i ASPA-s, ka vijuar procesi i trajnimit të nëpunësve të administratës publike nëpërmjet kurseve online, si dhe janë zhvilluar sesione informuese (në formën e webinarëve) të hapura me kohëzgjatje 1.5 – 2 orë, nëpërmjet platformës “GoToWebinar”.

Të dhëna të përgjithshme

Gjatë vitit 2022 ASPA ka trajnuar **5397** individë, që përkthehen në **20780** pjesëmarrje në seanca trajnuese. Në fushën e integritit evropian janë trajnuar 3755 pjesëmarrës. Gjithashtu gjatë këtij viti ASPA ka trajnuar 1195 individë në trajnimin e detyrueshëm për nëpunësit në periudhë prove “Prezantimi me Administratën Publike”. Në total janë zhvilluar 665 ditë trajnimi nga të cilat 139 në bashkëpunim me projektet. Duke ju referuar ndarjes sipas pushteteve, ASPA ka trajnuar 15883 pjesëmarrës nga administrata shtetërore dhe institucionet e pavarura dhe 4737 pjesëmarrës nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Të dhëna statistikore

Tabela 1: Numri i pjesëmarrësve dhe individëve unik në total



Tabela 2: Numri i pjesëmarrjeve sipas pushteteve

Pushtet qendror	Njësitë e vetëqeverisjes vendore	Institucionet e pavarura	Kod Pune
10889	4737	4994	160

Tabela 3: Numri i pjesëmarrjeve sipas niveleve nga pushteti qendror

Niveli ekzekutiv	Nivel i ulët drejtues	Nivel i mesëm drejtues	Nivel i lartë drejtues	Kod pune
8655	1132	500	80	522

Tabela 4: Numri i pjesëmarrjeve sipas niveleve nga pushteti vendor

Niveli ekzekutiv	Nivel i ulët drejtues	Nivel i mesëm drejtues	Nivel i lartë drejtues	Kod Pune
3810	527	200	32	168

Tabela 5: Numri i pjesëmarrjeve sipas niveleve për institucionet e pavarura

Niveli ekzekutiv	Nivel i ulët drejtues	Nivel i mesëm drejtues	Nivel i lartë drejtues	Kod Pune
4093	443	246	21	191






**TRAJNIM PËR TRAJNERË (TOT), TRAJNIMI I DETYRUESHËM
DHE TRAJNIMET NË ZBATIM TË PROCESVE TË PUNËS
ME AFATE LIGJORE**

2. TRAJNIM PËR TRAJNERËT (TOT)

ASPA gjatë vitit 2022 ka zhvilluar trajnime për trajnerë (ToT), të cilat i janë ofruar trupës së trajnerëve të ASPA, stafit të ASPA dhe pjesëmarrësve të tjerë që synojnë të zhvillohen si trajnerë.

Konkretisht, gjatë kësaj periudhe ASPA ka ofruar trajnime në fushat:

-  Dokumentacioni i BE-së dhe Qasja e re e Komisionit Evropian për të vlerësuar progresin e vendeve kandidate, në bashkëpunim me EIPA;
-  Zbatimi i ligjit të Bashkimit Evropian në nivelin kombëtar, në bashkëpunim me EIPA;
-  “Migracioni dhe Diaspora” në bashkëpunim me IOM.

3. TRAJNIMI I DETYRUESHËM “PREZANTIM ME ADMINISTRATËN PUBLIKE”

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, ASPA ka zhvilluar trajnimin e detyrueshëm për nëpunësit civilë në periudhë prove në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore. Në përmbushje të këtij detyrimi, ASPA gjatë vitit 2022 zhvilloi në total **349 ditë trajnimi** dhe ka trajnuar **1195 nëpunës**.



4. TRAJNIMET NË ZBATIM TË PROCESVE TË PUNËS ME AFATE LIGJORE

Në kuadër të zbatimit të proceseve të ndryshme të punës me afate ligjore shkolla ka ofruar trajnime për rritjen e kapaciteteve të nëpunësve të administratës publike si vijon:







- Në fushën e mbrojtjes së konsumatorit është zhvilluar një trajnim dhe kanë marrë pjesë 180 pjesëmarrës;
- Në fushën e etikës dhe integritetit në administratën publike janë zhvilluar 3 trajnime dhe kanë marrë pjesë 57 pjesëmarrës;
- Në fushën e prokurimit publik janë zhvilluar 4 webinarë dhe kanë marrë pjesë 177 pjesëmarrës;
- Në zbatim të Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut 2020-2023, ASPA ka zhvilluar kursin online me certifikim “Ndihma juridike parësore e garantuar nga shteti” që cili është organizuar në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD) dhe Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas në Ministrinë e Drejtësisë, si pjesë e projektit





“Shtrirja e shërbimit të ndihmës juridike për gratë dhe burrat në Shqipëri” me financim të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC). Në këtë kurs u trajnuan 17 individë. Gjithashtu u zhvilluan edhe 3 webinare me 117 pjesëmarrës;

- Në zbatim të “Strategjisë afatgjatë të zhvillimit të rrjetit arkivor kombëtar 2020 – 2030”, janë zhvilluar dy kurse online me temë “Përpunimi tekniko – shkencor i dokumenteve zyrtare” dhe 3 webinare me 168 pjesëmarrës;
- Në zbatim të “Strategjisë Kombëtare për Diasporën dhe planin e veprimit 2019 – 2022”, janë organizuar trajnime për trajnerët “Migracioni dhe Diaspora” dhe trajnimi në klasë “Forcimi i kapaciteteve institucionale për qeverisjen e migracionit në Shqipëri” në bashkëpunim me IOM. Në këtë fushë ASPA trajnoi 17 individë;
- Në zbatim të “Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, 2019-2022”, janë organizuar trajnime në fushën e politikave publike, politikëbërjes dhe statistikave, ku janë trajnuar 185 pjesëmarrës;
- Në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021-2025) janë zhvilluar 2 webinare dhe kanë marrë pjesë 50 pjesëmarrës;
- Në zbatim të “Strategjisë kombëtare për barazinë gjinore, 2021–2030, dhe të planit të saj të veprimit” janë zhvilluar 10 webinare dhe kanë marrë pjesë 397 pjesëmarrës. Eshtë zhvilluar një kurs online me certifikim me titull “Metodologjia dhe teknikat e integritit të gjinisë në proceset e Buxhetimit të përgjigjshëm gjinor”, ku kanë marrë pjesë 20 pjesëmarrës;
- Në zbatim të dokumentit strategjik “Udhërrëfyese për shërbimin civil”, ASPA ka hartuar modulën “Konsultimi publik” në të cilin trajtohen standartet, metodat e ndryshme dhe të gjitha aspektet e tjera të konsultimit publik;
- Në zbatim të dokumentit “Strategjia ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2021-2022” ASPA ka zhvilluar trajnimet e detyrueshme për nëpunësit në periudhë prove.

5. TRAJNIME SIPAS FUSHAVE

ASPA ka zhvilluar trajnime në disa fusha kryesore si:

-  *Antikorrupsioni*, ku janë zhvilluar 3 webinare dhe kanë marrë pjesë 65 pjesëmarrës;
-  *Etika në Administratën Publike dhe Konflikti i Interesave*, ku janë zhvilluar 10 webinare dhe kanë marrë pjesë 815 pjesëmarrës dhe kursi online me certifikim “Roli dhe detyrat e autoriteteve përgjegjës për deklarimin e pasurisë dhe konfliktit të interes” ku kanë marrë pjesë 26 pjesëmarrës;
-  *Ligji për shërbimin civil*, ku janë zhvilluar 2 webinare dhe kanë marrë pjesë 168 pjesëmarrës dhe 2 kurse online me certifikim “Rregullimi i marrëdhënies juridike të shërbimit civil” ku kanë marrë pjesë 36 pjesëmarrës;
-  *Informacion i klasifikuar "Sekret Shtetëror"*, ku është zhvilluar një webinar dhe kanë marrë pjesë 86 pjesëmarrës;


-  Marrëdhënie Ndërkombëtare, ku janë zhvilluar 2 webinare dhe kanë marrë pjesë 40 pjesëmarrës;
-  *Përfshirja sociale*, ku është zhvilluar një webinar dhe kanë marrë pjesë 39 pjesëmarrës;
-  *Përpunimi tekniko-shkencor i dokumenteve zyrtare*, ku janë zhvilluar 2 webinare dhe kanë marrë pjesë 234 pjesëmarrës;
-  *Standardet dhe roli i tyre në cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të ofruara*, ku është zhvilluar 1 webinar dhe kanë marrë pjesë 20 pjesëmarrës.



BASHKIMI EVROPIAN

6. TRAJNIMET NË FUSHËN E BASHKIMIT EVROPIAN

Në fushën e Bashkimit Evropian kanë marrë pjesë **3755 pjesëmarrës**. Ndërsa numri unik i individëve të trajnuar është **428**, nga të cilët **100** individë janë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.



Në vitin 2022 në bashkëpunim me projektin SANECA (GIZ) ka vijuar zhvillimi i trajnimeve për:

- 🇧🇪 Kapitullin 1 “Lëvizja e lirë e mallrave”;
- 🇧🇪 Kapitullin 20 "Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale";
- 🇧🇪 Kapitullin 3 “E Drejta e Vendosijs dhe Liria për të Ofruar Shërbime;
- 🇧🇪 Kapitullin 28 "Mbrotjtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik".

Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, nënshkruar me Institutin Evropian të Administratës Publike (EIPA) u zhvilluan dy trajnime për trajnerë ku morën pjesë **36 pjesëmarrës**.


- 🇧🇪 Dokumentacioni i BE-së dhe Qasja e re e Komisionit Evropian për të vlerësuar progresin e vendeve kandidate;
- 🇧🇪 Zbatimi i ligjit të Bashkimit Evropian në nivelin kombëtar.

Gjithashtu janë zhvilluar 2 webinarë të hapura “*Fundamental of the EU legal & institutional System & overview of the legal enlargement process*” në të cilët morën pjesë **185 pjesëmarrës**, si dhe një sërë webinarësh për kapitujt e *acquis communautaire* ku kanë marrë pjesë **550 pjesëmarrës**.

ASPA në bashkëpunim me projektin “Bashkitë për në Evropë 2.0”, ka organizuar trajnime në fushën e integritit evropian specifikisht në fushën e mbrotjtjes sociale, punësimit dhe të drejtave të konsumatorit. Në këto trajnime morën pjesë 69 pjesëmarrës.

Trajnime për Bashkimin Evropian sipas moduleve:

- ▣ “Auditimi i fondeve të asistencës së BE dhe kërkesat e standarteve ndërkombëtare të auditimit”, ku kanë marrë pjesë 373 pjesëmarrës dhe gjithashtu është zhvilluar një kurs online me certifikim në të cilin kanë marrë pjesë 22 individë dhe janë certifikuar 13 prej tyre;
- ▣ “Çështjet rregullatore të BE”, ku kanë marrë pjesë 254 pjesëmarrës;
- ▣ “Institucionet, politikat dhe vendimarrja në BE”, ku kanë marrë pjesë 218 pjesëmarrës;
- ▣ “Integrimi Evropian dhe negociatat e anëtarësimit në BE”, ku kanë marrë pjesë 430 pjesëmarrës;
- ▣ “Integrimi Evropian në nivel vendor”, ku kanë marrë pjesë 102 pjesëmarrës;
- ▣ “Menaxhimi financiar i fondeve të BE”, ku kanë marrë pjesë 107 pjesëmarrës.

 Në total në fushën e BE-së gjatë vitit 2022 u zhvilluan 8 aktivitete trajnuese, ku morën pjesë 1024 pjesëmarrës, si edhe 28 sesione informuese në total 42.5 orë, ose 7 ditë trajnimi.




**VLERËSIMI I NEVOJAVE PËR TRAJNIM DHE HARTIMI I
KURRIKULAVE**


7. VLERËSIMI I NEVOJAVE PËR TRAJNIM


ASPА në fillim të muajit Tetor nisi procesin e vlerësimit të nevojave për trajnim për vitin 2023 duke përfshirë të gjitha institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Informacioni i dërguar nga institucionet u përpunua nga stafi i ASPA-s, duke i prioritetuar këto nevoja bazuar në detyrimet ligjore, prioritetet strategjike dhe kuadrin strategjik, si dhe trajnimet për zhvillimin profesional. Rezultatet e vlerësimit të nevojave për trajnim, janë pasqyruar në programin e trajnimit për vitin 2023. Në këtë proces u evidentuan rreth **107 tematika trajnimi** të cilat janë përfshirë në programin e trajnimit, miratuar në mbledhjen e Këshillit Drejtues.

8. HARTIMI I KURRIKULAVE TË REJA

-  Gjatë kësaj periudhe në përmbushje të nevojave për trajnim ASPA ka vijuar punën për hartimin e kurrikulave të reja, i cili është bërë edhe me mbështetjen e programeve dhe donatorëve me të cilët ASPA bashkëpunon. Kështu me mbështetjen e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në zbatim të projektit “Forcimi i integritetit publik përmes përmirësimit të shërbimeve publike”, financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) u hartua kurrikula “Etika dhe integriteti në administratën publike” për trajnimin “Trajnim për Trajner”. Kohëzgjatja e kësaj kurrikule është parashikuar për 2 ditë ose 12 orë.
-  Gjithashtu me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare të migracionit IOM u hartua kurrikula “Statistikat e migracionit të punës në Shqipëri” pjesë e fushës Migracioni dhe Diaspora. Kohëzgjatja e kësaj kurrikule është 3 ditë ose 18 orë.
-  “*Qeveria Qendrore dhe Vetëqeverisja Vendore në Shqipëri*”, e zhvilluar në bashkëpunim me Institutin e Kërkimeve Urbane (URI) si pjesë e projektit “Asistenca Teknike e Këshillit Konsultativ të Qeverisë Qendrore dhe Vetëqeverisjes Vendore”, financuar nga Bashkimi Evropian. Kjo kurrikul ka për qëllim zhvillimin e kapaciteteve të stafit mbështetës të anëtarëve të Këshillit Konsultativ të Qeverisë Qendrore dhe Vendore për të kontribuar në përmirësimin, efikasitetin dhe efektivitetin e tij dhe kapacitetin për të çuar përpara axhendën e decentralizimit. Kjo kurrikul është e ngarkuar në Joomla LMS dhe është planifikuar të jepet si kurs e-Learning gjatë vitit 2023.
-  “*Buxheti Gjinnor si instrument i menaxhimit të buxhetit publik në Pushtetin Lokal*”, e zhvilluar në bashkëpunim me Agjencinë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS) dhe e implementuar nga CIES si pjesë e projektit “ALIVE”. Ky program trajnimi online ka njohur pjesëmarrësit me parimet e funksionimit, strategjitë dhe mjetet më të përdorura për integrimin e dimensionit gjinnor në proceset buxhetore të zyrtarëve të njëjësive të qeverisjes vendore. Duke filluar me bazat e BPGJ-së që përfshin një analizë të ciklit të buxhetimit, në trajnim u diskutua se si angazhimi i institucionit është thelbësor në vendosjen e prioriteteve efektive buxhetore që synojnë arritjen e drejtësisë gjinore, diversitetit dhe gjithëpërfshirjes. Kurrikula synon të sigurojë një bazë të përbashkët, për të gjithë institucionet pjesëmarrëse, të të kuptuarit se si të zbatohet një buxhet i përgjegjshëm gjinnor brenda institucioneve. Ajo ilustron pse buxheti i përgjegjshëm gjinnor ka rëndësi për institucionet, veçanërisht në transformimin e shpejtë të procesit të punës dhe ofron udhëzime praktike dhe mjete për të kostuar procesin e drejtësisë gjinore. Kjo kurrikul është e ngarkuar në Joomla LMS dhe është planifikuar të jepet si kurs e-Learning gjatë vitit 2023.
-  “*Të drejtat e komunitetit LGBTI në Shqipëri*”, e zhvilluar në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë Holandeze në Shqipëri dhe Aleanca LGBTI, ProLGBT, në kuadër të Planit Kombëtar

të Veprimit për të drejtat e njeriut të personave LGBTI në Shqipëri. Qëllimi kryesor i kësaj kurrikule e-learning është të: (i) informojë profesionistët në nivel vendor, mbi mënyrën sesi mund të mbështesin personat LGBTI+, duke i ndihmuar ata në sfidat e tyre dhe duke ju komunikuar pranim dhe mbështetje; (ii) të informojë dhe prezantojë tek profesionistët në nivel vendor rëndësinë e njohjes së terminologjisë profesionale gjatë praktikës së punës me personat e komunitetit LGBTI; (iii) të njohë pjesëmarrësit me nevojat dhe të drejtat e komunitetit LGBTI dhe bazën ligjore që zbaton vendi ynë për respektimin e tyre; (iv) të kuptohet rëndësia dhe ndikimi që kanë vlerat dhe qëndrimet personale në praktikën e punës me personat e komunitetit LGBTI; (v) të informojë profesionistët në nivel vendor me shërbimet aktuale që ofrohen për komunitetin LGBTI dhe të zhvillojë qasjen ndaj praktikave pozitive të punës në ofrimin e shërbimeve për personat e komunitetit LGBTI. Kjo kurrikul është e ngarkuar në Joomla LMS dhe është planifikuar të jepet si kurs e-Learning gjatë vitit 2023.

 “*EU Legal History*”, e zhvilluar në bashkëpunim me Ministrinë Federale Gjermane për çështjet ekonomike dhe të klimës si pjesë e projektit “*Digitalization of EU Training for the Public Administration in the Western Balkans*”. Kjo kurrikul është e ngarkuar në Joomla LMS dhe është planifikuar të jepet si kurs e-Learning gjatë vitit 2023.

 *Kodi i Procedurave Administrative* e zhvilluar nga trajneri i ASPA.



BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT

9. BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT








ASPA gjatë vitit 2022 zhvilloi 37 aktivitete trajnuese në bashkëpunim me partnerë dhe trajnoi **2032** nëpunës.

37

AKTIVITETE TRAJNUESE

2032

NËPUNËS TË TRAJNUAR

-  Në bashkëpunim me projektin "Ndihma teknike për Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit - Kontrata e Reformës së Sektorit për Luftën kundër Korrupsionit", u zhvillua trajnimi "Analiza në politikbërje dhe shkrimi i dokumenteve të politikave kundër korrupsionit" për pikat e kontaktit antikorrupsion. Në këtë cikël trajnimesh janë trajnuar 63 pjesëmarrës;
-  Në bashkëpunim me projektin "Përmirësimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile dhe sistemit të mbrojtjes së konsumatorëve në Shqipëri për të arritur standardet evropiane - PROTECT ME", janë zhvilluar 4 trajnime në klasë dhe 3 webinarë të hapura. Në total kanë marrë pjesë 159 pjesëmarrës;
-  Në bashkëpunim me projektin "Financim transformativ i barazisë gjinore për një qeverisje transparente, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse në Ballkanin Perëndimor" me financim nga Qeveria e Suedisë – SIDA, janë zhvilluar 9 trajnime në klasë për punonjësit e administratës shtetërore/ të pavarur me titull "Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjiner në përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025" dhe kanë marrë pjesë 146 pjesëmarrës. Gjithashtu janë zhvilluar 9 trajnime në klasë për punonjësit e njësisë të vetëqeverisjes vendore me titull "Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjiner në nivel vendor" dhe kanë marrë pjesë 115 pjesëmarrës;
-  Në bashkëpunim me projektin "Përmirësimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile dhe sistemit të mbrojtjes së konsumatorëve në Shqipëri për të arritur standardet evropiane- PROTECT ME", u organizua kursi online me certifikim "Ndihma juridike parësore e garantuar nga shteti". Në këtë kurs online morën pjesë 17 pjesëmarrës;
-  Në bashkëpunim me projektin "Financat Lokale" dhe projektin "Bashkitë për në Evropë" u zhvillua trajnimi me drejtuesit vendorë "Drejtimi i suksesshëm dhe menaxhimi i ndryshimit" ku morën pjesë 21 pjesëmarrës;
-  Në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Migracionit (IOM) në Shqipëri dhe me Institutin e Statistikave (INSTAT), u organizua trajnimi "Statistikat e migracionit të punës në Shqipëri". Në këtë trajnim morën pjesë 21 pjesëmarrës;
-  Në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim në zbatim të projektit "Forcimi i integritetit publik përmes përmirësimit të shërbimeve publike", u zhvilluan 2 trajnime me titull "Etika dhe Integriteti në Administratën Publike" për punonjësit e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Institutit të Shëndetit Publik. Gjithashtu në kuadër të këtij bashkëpunimi u zhvillua dhe trajnimi për trajnerë (TOT) me titull "Etika dhe Integriteti në Administratën Publike" ku morën pjesë 21 pjesëmarrës nga pushteti qendror;

- 🇲🇰 Në bashkëpunim me projektin e Asistencës Teknike për Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit me donator Bashkimin European dhe zbatuar nga Ministria e Drejtësisë u zhvillua një trajnim në klasë, ku morën pjesë 21 pjesëmarrës;
- 🇲🇰 Në bashkëpunim me projektin “Programi i Zhvillimit Rajonal në Shqipëri”, u zhvillua trajnim për trajnerë “Studimet e fizibilitetit të projektit” dhe 4 trajnime në rajone. Gjithashtu u zhvillua trajnimi për trajnerë mbi PRAG dhe 4 trajnime në rajone;
- 🇲🇰 Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit mes Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe Zyrës së GIZ në Shqipëri duke shënuar kështu një moment të rëndësishëm në historinë e bashkëpunimit.



KONTROLLI TË DHËNAVE

10. KONTROLLI TË DHËNAVE

Për qëllime të përpunimit të të dhënave dhe kontrollit të cilësisë, për çdo trajnim të zhvilluar nga ASPA mbledhen të dhëna që vetëdeklarohen nga pjesëmarrësit. Këto të dhëna përmbajnë informacionin kryesor dhe të nevojshëm për secilin pjesëmarrës në lidhje me trajnimin.

ASPA kontrollon me prioritet duke u kujdesur që qëllimet dhe objektivat e trajnimeve të jenë koherente duke zbatuar filozofinë dhe metodat bashkëkohore të procesit të mësimit të të rriturve (Gjashtë Parimet e Andragogjisë - Malcolm Knowles).

Gjithashtu, kontrolli ka për qëllim të evidentojë nëse synimet dhe objektivat e trajnimit janë në përputhje me kurrikulat e miratuara nga institucioni për modulet përkatëse.

ASPA gjithashtu kontrollon të dhënat e pjesëmarrësve brenda specifikimeve të paraqitura në ligjin për shërbimin Civil si: Ndarja e pjesëmarrësve sipas kategorisë dhe llojit të pozicionit.



Grafik 2. Numri i të dhënave (regjistra) të kontrolluara gjatë vitit 2022

Gjatë vitit 2022, ASPA ka kontrolluar **651** të dhëna (regjistra) për trajnimet e zhvilluara në ASPA, duke siguruar kështu saktësinë e këtyre të dhënave.



VLERËSIMI I TRAJNIMEVE DHE TRAJNERËVE

11. VLERËSIMI I TRAJNIMEVE NGA PJESËMARRËSIT

ASPA u jep pjesëmarrësve mundësinë të vlerësojnë trajnimet ku marrin pjesë në disa tipare kryesore të një trajnimi, si dhe të vlerësojnë trajnerët që japin trajnimet bazuar në nivelin e njohurive të trajnerit dhe aftësive të tyre prezantuese. Ky proces realizohet në kuadër të përpjekjeve për të adresuar sugjerimet dhe problematikat dhe për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të trajnimeve në aspektin cilësor.


Për shkak të specifikave të tyre dhe mënyrës së organizimit, trajnimet që ofron shkolla klasifikohen si vijon:

1. Prezantimi me administratën publike (Trajnimi i detyrueshëm)
2. Webinar (Sesione informuese me kohëzgjatje 1.5 orë mesatarisht)
3. Kurse me certifikim
4. Trajnime në klasë dhe Workshop



Grafik 3. Vlerësimi i trajnimeve nga pjesëmarrësit gjatë vitit 2022

12. NUMRI I VLERËSIMEVE TË TRAJNERËVE SIPAS LLOJIT TË TRAJNIMIT NGA PJESËMARRËSIT



Grafik 4. Numri i vlerësimeve të trajnerëve sipas llojit të trajnimit gjatë vitit 2022

Trajnerët janë vlerësuar nga pjesëmarrësit në trajnimet e tyre përse i përket njohurive në fushën ku kanë dhënë trajnim si dhe aftësitë e tyre prezantuese gjatë trajnimeve. Sektori i Cilësisë i ka mbledhur këto të dhëna duke respektuar edhe mendimin e pjesëmarrësve përse i përket trajnerëve të tyre të rekrutuar nga ASPA.

Nga analiza e bërë rezulton se **pjesëmarrësit kanë një vlerësim maksimal përse i përket njohurive mbi fushën e trajnimit të trajnerëve** të tyre në masën:

- 92.5% në trajnimet e detyruara (Induction)
- 88.9% në trajnimet specifike (Webinare)
- 93.8% në Kurse

Nga analiza e bërë rezulton se **pjesëmarrësit kanë një vlerësim maksimal përse i përket aftësive prezantuese të trajnerëve** të tyre në masën:

- 92.8% në trajnimet e detyruara (Induction)
- 87% në trajnimet specifike (Webinare)
- 94.2% në Kurse

13. VLERËSIMI I EFEKTIVITETIT TË TRAJNIMIT SIPAS LLOJIT TË TRAJNIMIT

► Trajnime induction

Tabela 5: Vlerësimi i përgjithshëm i trajnimeve të detyruara (Induction)

Si do ta vlerësonit në përgjithësi trajnimin online?	Nr. i vlerësimeve	Përqindja e vlerësimeve
Shumë mirë	4777	90.6%
Mirë	467	8.8%
Dobët	18	0.3%
Shumë dobët	5	0.09%
Pa plotësuar	2	0.03%
Totali	5269	

Nga analiza e bërë rezulton se **4777** pjesëmarrës nga **5269** në total janë shprehur të kënaqur me trajnimet, e cila përkon me **90.6%** të pjesëmarrësve të marrë në studim.

Tabela 6: Pritshmëritë

Në çfarë mase janë arritur pritshmëritë tuaja personale në trajnimin që zhvilluat?	Nr. i vlerësimeve	Përqindja e vlerësimeve
Plotësisht	4600	87.3%
Pjesërisht	662	12.5%
Asnjë	6	0.11%
Pa plotësuar	1	0.01%
Totali	5269	

Nga analiza e bërë rezulton se për **87.3%** e pjesëmarrësve ju janë plotësuar pritshmëritë e tyre që kanë patur rreth trajnimit.

Tabela 7: Interaktiviteti

Si do t'i vlerësonit metodat interaktive të përdorura në trajnim?	Nr. i vlerësimeve	Përqindja e vlerësimeve
Shumë efektive	3868	73.4%
Efektive	1382	26.2%
Aspak efektive	18	0.34%
Pa plotësuar	1	0.01%
Totali	5269	

Nga analiza e bërë rezulton se për **73.4%** e pjesëmarrësve mendojnë se metodat interaktive të përdorura në trajnim janë efektive

Tabela 8: Kohëzgjatja e trajnimeve

Si do ta vlerësonit kohëzgjatjen e trajnimit?	Nr. i vlerësimeve	Përqindja e vlerësimeve
Dakort	2800	53.1%
Mund të ishte më i gjatë	76	1.4%
Mund të ishte më i shkurtër	944	17.9%
Ishte shumë i gjatë	1447	27.4%
Pa plotësuar	2	0.03%
Totali	5269	

Nga analiza e bërë rezulton se **53.1%** e pjesëmarrësve e shohin të arsyeshme kohëzgjatjen e trajnimit

Tabela 9: Organizimi i trajnimeve

Si e vlerësoni ju gjithë administrimin dhe organizimin e webinarit? (Regjistrimin, ndarjen e informacionit, përputhja me programin, zgjidhjen e problemeve logjistike etj.)?	Nr. i vlerësimeve	Përqindja e vlerësimeve
Shumë mirë	4560	86.5%
Mirë	694	13.1%
Dobët	13	0.24
Shumë dobët	1	0.01
Pa plotësuar	1	0.01%
Totali	5269	

Nga analiza e bërë rezulton se **86.5%** e pjesëmarrësve e vlerësojnë maksimalisht të gjithë organizimin dhe administrimin e trajnimeve

➔ Webinare

Tabela 10: Vlerësimi i përgjithshëm i Webinareve

Si do ta vlerësonit në përgjithësi Webinarin?	Nr. i vlerësimeve	Përqindja e vlerësimeve
Shumë mirë	4148	86.4%
Mirë	568	11.8%
Dobët	18	0.37
Shumë dobët	9	0.18
Pa plotësuar	56	1.16
Totali	4799	

Nga analiza e bërë rezulton se **4148** pjesëmarrës nga **4799** në total janë shprehur të kënaqur me trajnimet në formën e webinarëve, e cila përkon me **86.4%** e tyre.

Tabela 11: Pritshmëritë

Në çfarë mase janë arritur pritshmëritë tuaja personale në trajnimin që zhvilluat?	Nr. i vlerësimeve	Përqindja e vlerësimeve
Plotësisht	3850	80.2%
Pjesërisht	837	17.4%
Aspak	25	0.5%
Pa plotësuar	87	1.8%
Totali	4799	

Nga analiza e bërë rezulton se për **80.2%** e pjesëmarrësve janë plotësuar pritshmëritë e tyre që kanë patur rreth trajnimit.

Tabela 12: Interaktiviteti

Si do t'i vlerësonit metodat interaktive të përdorura në trajnim?	Nr. i vlerësimeve	Përqindja e vlerësimeve
Shumë efektiv	3303	68.8%
Efektive	1356	28.2%
Aspak efektiv	35	0.7
Pa plotësuar	105	2.18%
Totali	4799	

Nga analiza e bërë rezulton se për **68.8%** e pjesëmarrësve mendojnë se metodat interaktive të përdorura në trajnim janë shumë efektive

Tabela 13: Kohëzgjatja e trajnimit

Si do ta vlerësonit kohëzgjatjen e Webinarit?	Nr. i vlerësimeve	Përqindja e vlerësimeve
Dakort	4162	86.7%
Mund të ishte më i gjatë	234	4.8%
Mund të ishte më i shkurtër	194	4%
Ishte shumë i gjatë	105	2.18%
Pa plotësuar	104	2.16
Totali	4799	

Nga analiza e bërë rezulton se **86.7%** e pjesëmarrësve e shohin të arsyeshme kohëzgjatjen e trajnimit.

Tabela 14: Organizimi i trajnimit

Si e vlerësoni ju gjithë administrimin dhe organizimin e Webinarit? (Regjistrimin, ndarjen e informacionit, përputhja me programin, zgjidhjen e problemeve logjistike etj.)?	Nr. i vlerësimeve	Përqindja e vlerësimeve
Shumë mirë	3907	81.4%
Mirë	739	15.3%
Dobët	25	0.5%
Shumë dobët	1	0.02
Pa plotësuar	127	2.6%
Totali	4799	

Nga analiza e bërë rezulton se **81.4%** e pjesëmarrësve e vlerësojnë maksimalisht të gjithë organizimin dhe administrimin e trajnimeve.


 Kurse me certifikim

Tabela 15: Vlerësimi i përgjithshëm i Kursit

Cili është vlerësimi juaj i përgjithshëm?	Nr. i vlerësimeve	Përqindja e vlerësimeve
Shumë mirë	157	93.4%
Mirë	10	5.9%
Pa plotësuar	1	0.6%
Totali	168	

Nga analiza e bërë rezulton se **157** pjesëmarrës nga **168** në total janë shprehur të kënaqur me trajnimet në formën e ëebinareve, e cila përkon me **93.4%** e tyre

Tabela 16: Pritshmëritë

Në çfarë mase janë arritur pritshmëritë tuaja personale në trajnimin që zhvilluat?	Nr. i vlerësimeve	Përqindja e vlerësimeve
Plotësisht	130	77.3%
Pjesërisht	37	22%
Pa plotësuar	1	0.6%
Totali	168	

Nga analiza e bërë rezulton se për **77.3%** e pjesëmarrësve janë plotësuar pritshmëritë e tyre që kanë patur rreth trajnimit.

Tabela 17: Interaktiviteti

Si do t'i vlerësonit metodat interaktive të përdorura në trajnim?	Nr. i vlerësimeve	Përqindja e vlerësimeve
Shumë efektive	122	72.6%
Efektive	44	26%
Aspak efektive	1	0.6%
Pa plotësuar	1	0.6%
Totali	168	

Nga analiza e bërë rezulton se për **72.6%** e pjesëmarrësve mendojnë se metodat interaktive të përdorura në trajnim janë shumë efektive.

Tabela 18: Kohëzgjatja e trajnimit

Si do t'a vlerësonit kohëzgjatjen?	Nr. i vlerësimeve	Përqindja e vlerësimeve
Dakort	164	97.6%
Mund të ishte më i gjatë	2	1.2%
Pa plotësuar	2	1.2%
Totali	168	

Nga analiza e bërë rezulton se **97.6%** e pjesëmarrësve e shohin të arsyeshme kohëzgjatjen e trajnimit

Tabela 19: Organizimi i trajnimit

Si e vlerësoni ju gjithë administrimin dhe organizimin e webinarit? (Regjistrimin, ndarjen e informacionit, përputhja me programin, zgjidhjen e problemeve logjistike etj.)?	Nr. i vlerësimeve	Përqindja e vlerësimeve
Shumë mirë	142	84.5%
Mirë	25	14.8%
Pa plotësuar	1	0.6%
Totali	168	

Nga analiza e bërë rezulton se **84.5%** e pjesëmarrësve e vlerësojnë maksimalisht të gjithë organizimin dhe administrimin e trajnimeve.



INFORMIMI PËR AKTIVITETET DHE REKRUTIMI I TRAJNERËVE


14. INFORMIMI PËR TRAJNIMET/AKTIVITETET DHE RRJETET ZYRTARE TË ASPA

Rëndësi e veçantë i është dhënë dhe informimit të administratës publike dhe më gjërë mbi aktivitetet dhe zhvillimet më të fundit që shkolla ka zhvilluar, me thirrjet për ekspertë dhe trajnimet që ASPA ka zhvilluar.

Rrjetet zyrtare të ASPA janë përditësuar rregullisht dhe sektori është siguruar që çdo ndërfaqe e rrjeteve të ketë saktësi konceptuale dhe të jetë e paraqitur sa më mirë vizualisht duke siguruar lehtësi në marrjen e informacionit për trajnimet që zhvillohen nga të interesuarit.

ASPA ka kontrolluar dhe verifikuar çdo të dhënë që publikohet në faqen zyrtare <https://aspa.gov.al/> dhe rrjetin zyrtar (Facebook) <https://www.facebook.com/ShkollaeAdministratesPublike/> dhe ka përditësuar periodikisht informacionet që kanë nevojë për përditësim.

ASPA gjatë vitit 2022 gjithashtu ka ndjekur rreth **900** emaille nga administrata dhe më gjërë në adresën aspa@aspa.gov.al.



15. REKRUTIMI I TRAJNERËVE

Gjatë vitit 2022 janë rekrutuar **60 trajnerë** të rinj për t'u angazhuar në trajnimet për Kapitujt e Acquis së Bashkimit Evropian. Angazhimi i tyre në trajnimet që ASPA ka ofruar ka nisur gjatë muajit qershor 2022.

60
Trajnerë

10
Trajnerë

Janë analizuar dhe vlerësuar 36 aplikime për trajnerë në 5 fusha:

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Kodi i Procedurave Administrative
- Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik
- Sistemi i Menaxhimit të Aplikimeve (AMS)
- Organizimi dhe funksionimi i administratës shtetërore

Pas vlerësimit të dokumenteve të secilit aplikant dhe intervistimit janë kontraktuar **10 trajnerë** për t'u angazhuar në trajnimet që ASPA zhvillon.

Gjithashtu ASPA ka mbyllur aplikimet dhe është në proces analizimi të aplikimeve për thirrjet më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Institucionet e Pavarura Kushtetuese dhe të Drejtat e Njeriut
- Decentralizimi
- E drejta e informimit
- Rregullat për Procesin Legjislativ
- Aftësitë Menaxhuese






VLERËSIMI I SHKOLLËS NGA TRAJNERËT

16. VLERËSIMI I SHKOLLËS NGA TRAJNERËT


ASPA në muajin dhjetor ka zhvilluar një pyetësor për trajnerët e angazhuar gjatë vitit 2022 ku ka mbledhur informacionin lidhur me organizimin dhe cilësinë e shërbimeve që ofron, me qëllim përmirësimin e cilësisë në të ardhmen.

Pyetësori është zhvilluar në 3 seksione:


- Të dhëna të përgjithshme;
- Vlerësimi i trajnimit;
- Rekomandime drejtuar institucioneve të administratës publike.




Si e vlerësoni moderimin nga punonjësit e ASPA?




Nëse ju ofroni kurs të strukturuar me certifikim, si e vlerësoni kohëzgjatjen e kursit (përkundrejt shkallës së vështirësisë dhe nevojës që kanë pjesëmarrësit)?




A janë aktiv pjesëmarrësit me pyetje dhe diskutime?



A kërkojnë pjesëmarrësit informacion shtesë?



Si e vlerësoni në tërësi për modulin tuaj nivelin e njohurive të pjesëmarrësve?



17. ANALIZA E VEPRIMTARISË TRAJNUESE ASPA

ASPA ka analizuar veprimtarinë trajnuese të zhvilluar gjatë vitit 2022 sipas:

- Temës së trajnimit;
- Numrit të pjesëmarrësve;
- Numrit të individëve;
- Zhvilluar nga ASPA/në bashkëpunim me projekt.

Tabela 20: Analiza e veprimtarisë trajnuese ASPA gjatë vitit 2022

Ref	Tema e trajnimit	Numri i pjesëmarrësve	Numri i individëve	Zhvilluar nga ASPA/Në bashkëpunim me projekt
1	Prezantimi me Administratë publike-pushteti qendror dhe institucionet e pavarura	5387	497	Zhvilluar nga ASPA
2	Prezantimi me Administratë publike-pushteti vendor	1888	313	Zhvilluar nga ASPA
3	Prezantimi me Administratë publike-pushteti qendror dhe institucionet e pavarura	168	168	Zhvilluar nga ASPA
4	Prezantimi me Administratë publike-pushteti vendor	217	217	Zhvilluar nga ASPA
5	Roli i aftësive menaxhuese në performancën e organizatës	30	30	Zhvilluar nga ASPA
6	Analiza mikroekonomike dhe efica e politikave qeveritare	31	31	Zhvilluar nga ASPA
7	Arbitrazhi ndërkombëtar i investimeve	19	19	Zhvilluar nga ASPA
8	Auditimi i fondeve të asistencës së BE dhe kërkesat e standarteve ndërkombëtare të auditimit	22	22	Zhvilluar nga ASPA
9	Auditimi i fondeve të asistencës së BE dhe kërkesat e standarteve ndërkombëtare të auditimit	373	255	Zhvilluar nga ASPA
10	Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi	20	20	Zhvilluar nga ASPA

11	Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi	395	281	Zhvilluar nga ASPA
12	Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi	149	149	Zhvilluar në bashkëpunim me projektin "Financim transformativ i barazisë gjinore për një qeverisje transparente, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse në Ballkanin Perëndimor" me mbështetjen e UN Women.
13	Buxheti i përgjigjshëm gjinor në nivel qendror	55	55	Zhvilluar në bashkëpunim me projektin "Financim transformativ i barazisë gjinore për një qeverisje transparente, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse në Ballkanin Perëndimor" me mbështetjen e UN Women.
14	Buxheti i përgjigjshëm gjinor në nivel vendor	75	75	Zhvilluar në bashkëpunim me projektin "Financim transformativ i barazisë gjinore për një qeverisje transparente, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse në Ballkanin Perëndimor" me mbështetjen e UN Women.
15	Çështjet rregullatore të BE	254	203	Zhvilluar nga ASPA
16	E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale	13	13	Zhvilluar nga ASPA
17	Etika dhe konflikti i interesave (deklarimi i pasurisë dhe interesave private)	553	553	Zhvilluar nga ASPA
18	Etika në administratën publike dhe konflikti i interesave	26	26	Zhvilluar nga ASPA
19	Etika në administratën publike dhe konflikti i interesave	307	248	Zhvilluar nga ASPA
20	Financat e vetëqeverisjes vendore dhe buxheti i përgjigjshëm gjinor në PBA	76	76	Zhvilluar në bashkëpunim me projektin "ALIVE- Gratë dhe burrat të lirë nga dhuna në Shqipëri. Mbështetje e politikave vendore për mundësi të barabarta", me mbështetjen e CIES – Centro Informazione ed Educazione allo Sviluppo

21	Fundamental of the EU legal & institutional System & overview of the legal enlargement process	185	130	Zhvilluar në kuadër të "Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Institutit Evropian të Administratës Publike (EIPA)
22	Hartim dhe menaxhim projekti	42	42	Zhvilluar nga ASPA
23	Hartim dhe menaxhim projekti	229	172	Zhvilluar nga ASPA
24	Hartimi i legjislacionit	23	23	Zhvilluar nga ASPA
25	Hartimi i legjislacionit	124	117	Zhvilluar nga ASPA
26	Informacion i klasifikuar "Sekret Shtetëror"	86	86	Zhvilluar nga ASPA
27	Institucionet politikat dhe vendimarrja në BE	218	174	Zhvilluar nga ASPA
28	Integrimi Evropian dhe negociatat e anëtarësimit në BE	430	246	Zhvilluar nga ASPA
29	Integrimi Evropian në nivel vendor	102	101	Zhvilluar në bashkëpunim me projektin 'Bashkitë për në Evropë'
30	Inteligjenca emocionale	73	71	Zhvilluar nga ASPA
31	Investimet publike	21	21	Zhvilluar nga ASPA
32	Investimet publike	53	50	Zhvilluar nga ASPA
33	Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave	68	51	Zhvilluar në bashkëpunim me projektin "Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik (SANECA)", mbështetur nga GIZ
34	Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave	83	51	Zhvilluar në bashkëpunim me projektin "Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik (SANECA)", mbështetur nga GIZ
35	Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave	28	27	Zhvilluar në bashkëpunim me projektin "Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik (SANECA)", mbështetur nga GIZ

36	Kapitulli 28: Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik	63	47	Zhvilluar në bashkëpunim me projektin "Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik (SANECA)", mbështetur nga GIZ
37	Kapitulli 3: E Drejta e Vendosijes dhe Liria për të Ofruar Shërbime	38	38	Zhvilluar në bashkëpunim me projektin "Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik (SANECA)", mbështetur nga GIZ
38	Kapitulli 3: E Drejta e Vendosijes dhe Liria për të Ofruar Shërbime	42	31	Zhvilluar në bashkëpunim me projektin "Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik (SANECA)", mbështetur nga GIZ
39	Komunikim strategjik dhe marrëdhënia me publikun	56	54	Zhvilluar nga ASPA
40	Konflikti, negociimi dhe vendimmarrja	20	20	Zhvilluar nga ASPA
41	Konsultimi publik	180	143	Zhvilluar nga ASPA
42	Kontratat e partneritetit publik privat dhe koncesionet	11	11	Zhvilluar nga ASPA
43	Korrupsioni në administratën publike mekanizmat e identifikimit dhe lufta ndaj tij	84	84	Zhvilluar në bashkëpunim me projektin "Projektin e Asistencës Teknike për Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit"
44	Korrupsioni në administratën publike mekanizmat e identifikimit dhe lufta ndaj tij	45	45	Zhvilluar nga ASPA
45	Lidershipi	17	17	Zhvilluar nga ASPA
46	Lidershipi	136	134	Zhvilluar nga ASPA
47	Marrëdhënie ndërkombëtare	39	37	Zhvilluar nga ASPA
48	Mbrojtja e konsumatorëve, një qasje e re midis institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore	63	58	Zhvilluar në bashkëpunim me projektin Qendra "Konsumatori Shqiptar"
49	Mbrojtja e konsumatorëve, një qasje e re midis institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore	117	104	Zhvilluar në bashkëpunim me projektin Qendra "Konsumatori Shqiptar"
50	Menaxhim i ndryshimit	99	91	Zhvilluar nga ASPA
51	Menaxhimi financiar i fondeve të BE	107	89	Zhvilluar nga ASPA
52	Menaxhimi i riskut	246	214	Zhvilluar nga ASPA

53	Menaxhimi i riskut	17	17	Zhvilluar nga ASPA
54	Mendimi kritik	19	19	Zhvilluar nga ASPA
55	Mendimi kritik	76	69	Zhvilluar nga ASPA
56	Ndihma juridike parësore e garantuar nga shteti	17	17	Zhvilluar nga ASPA
57	Ndihma juridike parësore e garantuar nga shteti	117	117	Zhvilluar nga ASPA
58	Negocimi dhe vendimmarja konkurruese	18	18	Zhvilluar nga ASPA
59	Negocimi dhe vendimmarja konkurruese	26	26	Zhvilluar nga ASPA
60	Paketa office	42	42	Zhvilluar nga ASPA
61	Paketa office	416	315	Zhvilluar nga ASPA
62	Përdorimi i mediave sociale në administratën publike	110	104	Zhvilluar nga ASPA
63	Përfshirja sociale	38	38	Zhvilluar nga ASPA
64	Përpunimi tekniko-shkencor i dokumenteve zyrtare	408	369	Zhvilluar nga ASPA
65	Përpunimi tekniko-shkencor i dokumenteve zyrtare	17	17	Zhvilluar nga ASPA
66	Planifikimi buxhetor dhe pasqyrat financiare	57	57	Zhvilluar nga ASPA
67	Planifikimi buxhetor dhe pasqyrat financiare	1213	753	Zhvilluar nga ASPA
68	Planifikimi strategjik	36	35	Zhvilluar nga ASPA
69	Planifikimi strategjik	154	123	Zhvilluar nga ASPA
70	Prokurimi publik	1237	675	Zhvilluar nga ASPA
71	Qeverisja elektronike dhe siguria kibernetike	117	103	Zhvilluar nga ASPA
72	Qeverisja elektronike dhe siguria kibernetike	14	14	Zhvilluar nga ASPA
73	Statistika zyrtare	165	124	Zhvilluar nga ASPA

74	Statistika zyrtare	22	22	Zhvilluar nga ASPA
75	Studimet e fizibilitetit	90	90	Zhvilluar në bashkëpunim me projektin "Programi për Zhvillimin Rajonal "
76	Suksesi personal	319	221	Zhvilluar nga ASPA
77	Suksesi personal	32	32	Zhvilluar nga ASPA
78	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme - përjasje të politikave fiskale dhe sfida të administrimit	118	89	Zhvilluar në bashkëpunim me projektin "Financat lokale"
79	Teknikë legjislative	93	79	Zhvilluar nga ASPA
80	Trajnimi për trajnerë "Të mësuarit tek të rriturit"	17	17	Zhvilluar në bashkëpunim me projektin "Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik (SANECA)", mbështetur nga GIZ
81	Trajnim i thelluar për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues	439	367	Zhvilluar nga ASPA
82	Trajnim për trajnerë për politikën e migracionit dhe diasporës	8	8	Zhvilluar nga ASPA
83	Udhëzuesi për procedurat e prokurimit, dhënies së granteve dhe kontratave për veprimet e jashtme të Bashkimit Evropian (PRAG)	19	19	Zhvilluar në bashkëpunim me projektin "Programi për Zhvillimin Rajonal "
84	Vlerësimi, kontrolli dhe auditimi	493	313	Zhvilluar nga ASPA
85	Ëëbinare për kapitujt e acquis communautaire	550	311	Zhvilluar nga ASPA
86	Zbatimi i ligjit të shërbimit civil	34	34	Zhvilluar nga ASPA
87	Zbatimi i ligjit të shërbimit civil	168	157	Zhvilluar nga ASPA
88	Zhvillimi i politikave publike	53	53	Zhvilluar nga ASPA
89	Dokumentacioni i BE-së dhe Qasja e re e Komisionit Evropian për të vlerësuar progresin e vendeve kandidatë	20	20	Në bashkëpunim me projekt
90	Hyrje në politikën e mbrojtjes shëndetësore të BE	15	15	Në bashkëpunim me projekt
91	Kapitulli 20 "Politikat sektoriale – sektorët me interes të veçantë për Shqipërinë"	70	43	Në bashkëpunim me projekt
92	Regjistri i përdorimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve në fermë	182	182	Në bashkëpunim me projekt

93	Zbatimi i ligjit të Bashkimit Evropian në nivelin kombëtar	16	16	Në bashkëpunim me projekt
94	Industria dhe Arsimi	22	22	Në bashkëpunim me projekt
95	Etika dhe Integriteti në Administratën Publike	78	78	Në bashkëpunim me projekt
96	Statistikat e migracionit të punës në Shqipëri	17	17	Në bashkëpunim me projekt
97	Ndihma juridike parësore e garantuar nga shteti	17	17	Në bashkëpunim me projekt
98	Programi buxhetor afatmesëm dhe monitorimi i tij	24	24	Zhvilluar nga ASPA
99	Drejtimi i suksesshëm dhe menaxhimi i ndryshimit	21	21	Në bashkëpunim me projekt
100	Kuptueshmëria dhe mirëadministrimi i procedurave administrative	34	34	Zhvilluar nga ASPA
101	Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave_Kimikatat	18	18	Në bashkëpunim me projekt
102	Kapitulli 20 "Politikat sektoriale – sektorët me interes të veçantë për Shqipërinë"	18	18	Në bashkëpunim me projekt
103	Vendimi 434 mbi Rregullat e etikimit dhe informimin e konsumatorit	214	214	Në bashkëpunim me projekt
104	Produktet mjekësore për përdorim njerëzor	4	4	Në bashkëpunim me projekt
105	Shëndeti mendor, alkooli, droga	4	4	Në bashkëpunim me projekt
106	Çështjet shëndetësore ndërkufitare	4	4	Në bashkëpunim me projekt
107	Mbrojtja sociale dhe punësimi	21	21	Në bashkëpunim me projekt
108	Bujqësia dhe Mjedis	26	26	Në bashkëpunim me projekt
Total		20780		



SHKOLLA SHQIPTARE E ADMINISTRATËS PUBLIKE

www.aspa.gov.al
aspa@aspa.gov.al